



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kacanik
Municipality Kacanik

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, më datë 14.10.2014 shpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

INSPEKTOR I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Drejtoria: Drejtoria për emergjencë dhe shërbime publike

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: koeficienti 7.

Numri i referencës së vendit të punës: 112-28061/14

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Mbikëqyr kycjet me/pa leje në sistemin e rrjetit të ujësjellësit publik nga ana e personave fizik dhe juridik,
2. Mbikëqyr shfrytëzimin dhe keqpërdorimin e ujit të pijshëm me/pa leje (larja e rrugëve, sipërfaqeve të hapura publike, autolarjet, mbushja e puseve, ujitja e kopshteve etj.
3. Mbikëqyr kycjet me/pa leje në sistemin e rrjetit të kanalizimit publik, mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit
4. Mbikëqyr mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike dhe ndërhyrjet në infrastrukturë të qytetit dhe të fshatit me /pa leje(rruge , trotuare sheshe, parqe, varreza, treg i gjelbër, terrene sportive dhe sip. tjera)
5. Mbikëqyrë hedhjen e mbeturinave jashtë vendeve të caktuara dhe zbrazjen me/pa leje të materialeve tjera (rërës, dheut, materialit ndërtimor etj) që pengojnë qarkullimin e lirë të qytetarëve dhe automjeteve,
6. Mbikëqyr rrethojat përballë sipërfaqeve publike dhe ndalimin e ekspozimit të mallrave jashtë lokaleve afariste
7. Mbikëqyrë ndriçimin publik, mbishkrimet, reklamat, firmat, higjienën ne objekte publike etj.
8. Kryen edhe detyra tjera sipas përshkrimit të vendit të punës dhe legjislacionit ne fuqi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurrit: - është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Përgatitje universitare
- Të kenë së paku tri vite përvojë pune
- Të njoh mirë punën me kompjuter
- Aftësi të dëshmuara për vetiniciativë dhe vetorganizim
- Aftësi për të krijuar raporte të mira pune dhe ndërpersonale
- Patentë shoferi

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit : sipas legjislacionit ne fuqi.

Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimore -**Zyra e pranimit**, kati përdhës dhe ne web-faqen komunale .

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomën e Fakultetit të kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, Dëshmi për përvojen e punës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes, certifikata mbi trajnimet e kryera, Çertifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore, dëshminë se nuk është në hetime.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Irazi

